



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

KUMTESË PËR MEDIA
16 PRILL 2018

Shoqëria e alarmuar nga rastet e dhunës ndaj grave

Java që e lam pas u shënuar me disa raste të dhunës ndaj grave. Për këto raste Rrjeti i Grave të Kosovës u njoftua përmes mediave lokale por edhe nga kontaktet e drejtëpërdrejta të familjarëve dhe të njohurve të viktimave të dhunës.

Në fshatin Varosh të komunës së Ferizajt me datë 14 prill 2018, një i moshuar kishte sulmuar me sopatë bashkëshorten e tij. Si pasojë e lëndimeve të fituara, viktimja është dërguar në trajtim mjekësor, ndërsa i dyshuari për këtë vepër është dërguar në mbajtje me urdhër të prokurorit. Rasti është trajtuar si “vrasje e rëndë në tentativë”, ndërsa nuk është përmendur nëse ky rast po trajtohet edhe si rast i dhunës në familje, shkruajnë mediat lokale. Nga familjarët dhe të njohurit e viktimës, u kuptua që si pasojë e traumës psikologjike të fituar pas sulmit me sopatë, edhe anëtarë të tjerë të kësaj familje janë duke pranuar trajtim mjekësor, për të kaluar përjetimin traumatik. Sipas po këtyre burimeve, më të prekurit janë fëmijët e kësaj familje, të cilët ishin të pranishëm kur kishte ndodhur rasti.

Studimet e bëra në Kosovë, por edhe në botë, tregojnë për pasojat që lë dhuna. Këto pasoja nuk mbesin vetëm në viktimën por edhe tek dëshmitarët e dhunës. Ndjenja e turpit, e vetmisë, mungesa e vetëbesimit, abuzimi me droga dhe alkohol, paaftësia për të krijuar marrëdhënie të shëndosha shoqërore dhe emocionale, janë disa prej problemeve të cilat shfaqen tek personat që kanë përjetuar dhunën apo kanë qenë të pranishëm në situata të dhunës.

Prandaj, duke i patur parasysh pasojat dhe ndikimin që dhuna ka tek individët por edhe tek shoqëria, RrGK bënë thirrje që dhuna të ndaloj. Kjo është e mundur nëse ne, e tërë shoqëria, e denojmë dhe nuk e tolerojmë dhunën. Poashtu, RrGK u bënë thirrje institucioneve të rendit dhe ligjit, që të trajtojnë seriozisht të gjitha rastet e dhunës ndaj grave, dhe aty ku ka elemente të dhunës në familje, të trajtohen si të tilla, duke e patur parasyshë peshën që i bie një krimi, në rast se ai krim shaktohet në marrëdhënie familjare.